



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë - Akademija Pravde - Academy of Justice

Buletini informativ

- **Aktivitetet e përgjithshme**
- * **Aktivitetet nga Programi I Trajnimit Fillestar (PTF)**
- * **Aktivitetet nga Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV)**
- * **Aktivitetet për stafin administrative gjyqësor dhe prokurorial**
- * **Aktivitetet për profesionistët tjerë ligjor**

Mars 2022

Aktivitetet e përgjithshme

Takim me përfaqësues nga Fondacioni Gjerman për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar (IRZ) dhe EUKOJUST

Më 03 mars 2022, Drejtori Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë, z. Enver Fejzullahu, priti në takim përfaqësuesit nga Fondacioni Gjerman për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar (IRZ), znj. Teresa Thalhammer, Drejtoreshë e Projektit, znj. Trime Ahmeti, Menaxhere e projektit dhe z. Volkmar Theobald, Udhëheqës i ekipit të projektit, si dhe z. Dragomir Yordanov nga Programi i Sektorit të Drejtësisë të Bashkimit Evropian/Kosovës (EUKOJUST).

Gjatë këtij takimi, Drejtori Ekzekutiv i AD-së falënderoj të pranishmit për mbështetjen e vazhdueshme të institucionit që ai përfaqëson, si

dhe i njoftoj për të arriturat dhe sfidat e deritanishme. Derisa, Drejtoresha e Projektit znj. Thalhammer, ri theksoi mbështetjen e IRZ-së, për Akademinë e Drejtësisë bazuar në nevojat dhe prioritetet e Akademisë, me qëllim të implementimit të këtij projekti.

Në fund të takimit, bashkëbiseduesit shprehën gatishmërinë për thellimin e bashkëpunimit në fushat e interesit të përbashkët ndërinstitucional, me qëllim të ngritjes së efikasitetit, transparencës dhe llogaridhënies në kuadër të sistemit gjyqësor.



Takim me përfaqësues nga Shërbimi Federal i Ndërmjetësimit dhe Pajtimit (FMCS) të SHBA-së

Më 14 mars 2022, Drejtori Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë, priti në takim përfaqësuesit e



Shërbimit Federal të Ndërmjetësimit dhe Pajtimit (FMCS) të SHBA-së.

Ky takim erdhi si rezultat i nismës së organizuar për rekrutimin e trajnerëve në fushën e Ndërmjetësimit nga Akademia e Drejtësisë dhe

Shërbimit Federal të Ndërmjetësimit dhe Pajtimit (FMCS) të SHBA-së, të mbështetur dhe të financuar nga Zyra për Çështje Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe të Zbatimit të Ligjit (INL) pranë Ambasadës së SHBA-së.

Qëllimi i programit trajnues në fushën e Ndërmjetësimit është përpjekja e vazhdueshme e AD-së për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve të ndërmjetësimit në Kosovë.

Akademia e Drejtësisë ka kënaqësinë që brenda periudhës 2 javore, nga data 14 mars 2022 deri më 25 mars 2022, të mirëpres ekspertët nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës z. Peter Swandon, znj. Emily Rife dhe z. David Moora, të cilët do jenë përgjegjës në intervistimin dhe për zgjedhjen e kandidatëve për trajnues në fushën e Ndërmjetësimit brenda Akademisë së Drejtësisë.

Takimi i Këshillit Programor të Akademisë së Drejtësisë

Më 23 mars 2022, në Akademinë e Drejtësisë është mbajtur takimi i radhës i Këshillit Programor të AD-së.

Në fokus të këtij takimi, si pika kryesore ishin diskutimi i Draft - Programit Fillestar për prokurorët gjenerata e nëntë 2022/2023, si dhe diskutimi i Draft- Plotësim Ndryshimit të Rregullores Nr. 02/2019 për Trajnues dhe Mentorë të Akademisë së Drejtësisë, ku njëkohësisht anëtarët e KP i dhanë edhe rekomandimet e tyre, të cilat do t'i prezantohen Këshillit Drejtues të AD-së për diskutim dhe miratim në takimin e radhës.

Gjatë takimit, anëtarët e Këshillit Programor shqyrtuan dhe diskutuan edhe listën e trajnuesve të certifikuar për trajnimin e gjyqtarëve të

Gjykatës Komerciale, me ç'rast unanimitisht rekomanduan miratimin e kësaj liste nga ana e Këshillit Drejtues, për t'u përfshirë të njëjtit si



trajnues të përkohshëm në Akademinë e Drejtësisë.

Tryezë – Krijimi i Rrjetit Miqtë e Akademisë së Drejtësisë

Me datë 28 Mars 2022, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me projektin EUKOJUST organizoi punëtorinë “Forcimi i qasjes në drejtësi përmes trajnimit gjyqësor në partneritet me shoqërinë civile - krijimi i rrjetit ”Miqtë e Akademisë së Drejtësisë në Kosovë”.

Qëllimi i tryezës është diskutimi i krijimit të një mekanizmi koordinues ndërmjet Akademisë së Drejtësisë dhe organizatave të shoqërisë civile në avancimin e bashkëpunimit dhe ofrimin e aktiviteteve të trajnimit në ngritjen e kapaciteteve në fushën e sundimit të ligjit, nën ombrellën e Miqve të Akademisë.

Shoqëria civile në Kosovë ka një rol të fuqishëm në monitorimin dhe ngritjen e vetëdijes në çështjet e drejtësisë, veçanërisht aty ku ka mangësi të forta që duhet të ngrihen dhe adresohen. Një partneritet i fortë ndërmjet Akademisë dhe shoqërisë civile është thelbësor në promovimin e praktikave të mira për gjyqtarët, prokurorët dhe stafin mbështetës në çështjet që lidhen me të drejtat e njeriut, korrupsionin, krimin e organizuar, dhunën në familje e posaçërisht qasjen në drejtësi.

Temat të cilat u trajtuan gjatë punëtorisë kryesisht ndërlidheshin me rrolin e shoqërive civile dhe organizatave jo qeveritare në ngritjen e kapaciteteve të profesioneve të lira, efikasiteti i trajnimeve të organizuara nga Akademia dhe trajtimi i temave specifike nga organet e drejtësisë në Kosovë.

Përfaqësues të organizatave jo qeveritare dhe nga shoqëria civile mirëpritën bashkëpunimin me Akademinë e Drejtësisë ku edhe shprehën gatishmëri për një koordinim më të mirë në të ardhmen. Gjithashtu, për konceptin Miqtë e Akademisë së Drejtësisë, Akademia synon të krijoj një mekanizëm bashkëpunimi përmes nënshkrimit të një Memorandumi të Mirëkuptimit ndërmjet organizatave të shoqërisë civile dhe Akademisë së Drejtësisë për mes të cilit do të forcohet edhe më tej bashkëpunimi në mes të Akademisë dhe organizatave të lartpërmendura në realizimin e qëllimit të përbashkët.



Takimi i Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë

Më 30.03.2022, në Akademinë e Drejtësisë u mbajt mbledhja e radhës e Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë, e kryesuar nga Kryetari i Këshillit, z. Vatton Durguti, shef i Departamentit të Posaçëm në Gjykatën e Apelit.

Në këtë takim, anëtarët e Këshillit Drejtues diskutuan për draft Programin Fillestar për Prokurorët e gjeneratës së Nëntë 2022/2023, të cilët janë në proces të rekrutimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës, si dhe listën e moduleve nga Programi i Trajnimit për këtë gjeneratë.

Këshilli Drejtues vlerësoi se draft Programi i Trajnimit Fillestar për Prokurorët e gjeneratës së IX plotëson të gjitha kriteret e programit, është mjaft profesional dhe është miratuar unanimisht së bashku me listën e moduleve nga Programi i

Trajnimit për Gjyqtarët e sapoemëruar,

Drejtori Ekzekutiv i Akademisë prezantoi shkurtimisht edhe Raportin Vjetor të Punës për vitin 2021, i cili përmban të gjitha aktivitetet e realizuara nga Akademia gjatë vitit 2021. Anëtarët e Bordit Drejtues, duke vlerësuar punën e Akademisë gjatë vitit 2021, miratuan njëzëri raportin e paraqitur.

Në këtë mbledhje të Këshillit Drejtues të AD-së u miratua lista e trajnerëve të certifikuar në fushën e Drejtësisë Tregtare, të cilët do të përfshihen si trajnerë të përkohshëm në Akademinë e Drejtësisë.



Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve Fillestare

Trajnimi fillestarë për gjyqtarët e sapo emëruar gjenerata (VIII)

Gjatë muajit mars, gjenerata e VIII e gjyqtarëve të sapo emëruar ka vazhduar me sesionet e trajnimit praktik në lëmine penale në gjykatat përkatëse ku janë të emëruar deri me 18 mars 2022. Kjo datë shënon përfundimin e sesioneve të trajnimit praktik dhe trajnimeve fillestare në përgjithësi konform planit dhe programit trajnues për këtë gjeneratë.

Bazuar në Rregulloren e trajnimit fillestar dhe kalendarin trajnues me 09 dhe 10 mars 2022 është zhvilluar testi përfundimtarë për këtë gjeneratë në modulën penal të ndjekur së fundmi në program, përkatësisht në nënmodulet “Kodi Penal i Republikës së Kosovës”, “Kodi i Procedurës Penale” dhe moduli “Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese”.

Pas përfundimit të testit është bërë vlerësimi përfundimtar dhe me 17 mars 2022 është bërë shpallja e rezultateve konform afatit të përcaktuar me rregulloren e këtij programi.

Aktivitet tjetër me rëndësi gjatë këtij muaji është edhe përgatitja e dosjeve fizike dhe elektronike e gjyqtarëve që përfshijnë raportet përfundimtare për secilin gjyqtar të kësaj gjenerate të cilat i dorëzohen Komisionit për vlerësimin e performancës në Këshillin Gjyqësor të Kosovës.


Kjo gjeneratë zyrtarisht ka filluar trajnimin fillestar me datë 18 shkurt 2021. Përfitues të kësaj gjenerate 2021/2022 ishin 24 gjyqtarë të sapo emëruar, dy prej tyre të komunitetit serb.



Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme

Trajnimi: Konflikti Administrativ objekti dhe procedura e konfliktit administrativ

Më 01 mars 2022, është realizuar trajnimi online përmes platformës ZOOM me temë “Konflikti Administrativ, objekti dhe procedura e konfliktit



administrativ”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me procedurën e konfliktit administrativ për vendosjen e lëndëve në mënyrë meritore nga ana e gjykatës.

Me rastin e këtij trajnimi u trajtua në detaje konflikti administrativ, parimet dhe rregullat kryesore të Ligjit për konfliktin administrativ, procedura në bazë të padisë, seanca e shqyrtimit kryesor-nxjerrja e provave dhe aktgjykimit si dhe në fund procedura sipas mjeteve juridike. Pra, trajnimi u fokusua në trajtimin e procedurës së inicimit të konfliktit administrativ, mënyrën se si zhvillohet ajo nga gjykata kompetente ndaj vendimeve të organeve të administratës publike dhe organeve të qeverisjes në Kosovë me të cilat është shkelur ligji në dëm të personit fizik apo personit juridik si dhe cilat lloje të lëndëve paraqiten më shpesh pranë Departamentit për Çështje Administrative.

Gjatë trajnimit u tha se konflikti administrativ mund të iniciohet vetëm kundër aktit administrativ të nxjerr në procedurën administrative në shkallë të dytë. Konflikti administrativ mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë, kundër të cilit në procedurën administrative, nuk është lejuar ankesa. Gjithashtu konflikti administrativ mund të filloj edhe kur organi kompetent nuk ka nxjerrë akt përkatës administrativ sipas kërkesës ose ankesës së palës nën kushtet e parapara me LKA

Përmes rastit praktik gjyqtarët pjesëmarrës në trajnim patën rastin e diskutimit të dispozitave ligjore që duhet zbatuar në rastin konkret dhe njëkohësisht të evitojnë dilemat e ndryshme profesionale procedurale dhe materiale përkitazi me vendosjen e lëndëve të ngjashme.

Metodologjia e trajnimit ishte e karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive duke prezantuar dhe raste praktike.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 12 gjyqtarë (3 nga Departamenti për Çështje Administrative dhe 9 nga Departamenti i përgjithshëm) si dhe 1 prokurorë. Të gjithë pjesëmarrësit ishin nga niveli themelor themelor i gjykatave e Departamentit për çështje Administrative të Gjykatës së Apelit dhe gjyqtarët e Departamentit për çështje Administrative të Gjykatës Themelore.

Trajnim: Menaxhimi stresit

Më 02 Mars 2022, është realizuar trajnimi online përmes platformës ZOOM me temë “Menaxhimi stresit”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte zhvillimi i shkathtësive interdisciplinare të gjyqtarëve dhe prokurorëve për mënyrat dhe teknikat e përmbajtjes emocionale për mbajtjen nën kontroll të stresit gjatë punës në gjykata dhe prokurori dhe rrethanave të ndryshme të jetës.


Trajnimi u fokusua në elaborimin e faktorëve të stresit, llojet e stresit, shenjat dhe simptomat paralajmëruese të stresit, stresi në punë dhe administrimi i kohës.

Gjatë trajnimit u potencua se menaxhimi i mirë i kohës dhe prioritizimi i nevojave është faktorë

kyq për mbajtjen në kontroll të vazhdueshëm të stresit. Gjithashtu planifikimi me rigorozitet e arsyeshmëri të plotë të prioriteteve ditore, javore e mujore është treguar si strategji e suksesshme e menaxhimit të stresit nga e cila pason edhe rritja e cilësisë së performances në punë dhe përmirësimi i standardit të jetesës.

Metodologjia e trajnimit ishte e karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 27 gjyqtarë (3 nga Gjykata e Apelit dhe 24 të tjerë nga Gjykatat Themelore) dhe 6 prokuror nga Prokuroritë Themelore.



Trajnim: Ndryshimet në Kodin e Drejtësisë për të Mitur

Më 03 Mars 2022, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me EULEX në kuadër të Programit për Trajnimeve të Vazhdueshme ka realizuar trajnimin në mënyrë hibride me prezencë fizike dhe atë online përmes platformës zoom me temë "Ndryshimet në Kodin e Drejtësisë për të mitur".

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve për të mitur lidhur me risitë ligjore të Kodit të Drejtësisë për të Mitur dhe zbatimit të drejtë në praktikën gjyqësore.

Trajnimi u fokusua në trajtimin teorik dhe praktik duke i kushtuar kujdes dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve viktime apo dëshmitarë si dhe parimeve të përgjithshme që përmban ky kod

dhe veprimet procedurale.

Gjatë trajnimit pjesëmarrësit patën rastin që përmes rastit praktik të zbërthejnë dispozitat ligjore që janë risi në këtë kod dhe të ofrojnë zgjidhjen meritorë të rastit përkatës.


Metodologjia e trajnimit ishte e karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive duke prezantuar dhe raste praktike.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 12 gjyqtarë dhe 23 prokurorë nga Departamenti për të Mitur si dhe Departamenti i përgjithshëm si dhe 4 zyrtar nga Shërbimi Sprovues i Kosovës si dhe një hetues nga Policia e Kosovës.



Trajnim: Anulimi i kontratave dhe mjetet e sigurimit të kontratave

Më 08-09 Mars 2022, është realizuar trajnimin përmes formës hibride, prezencës fizike dhe platformës ONLINE, me temë “Anulimi i kontratave dhe mjetet e sigurimit të kontratave”.



Në ditën e parë të trajnimit janë trajtuar Kontratat e rrëzueshme, shkaqet ligjore të cilat e bëjnë një kontratë të rrëzueshme, subjektet e cilët mund të kërkojnë anulimin e kontratave të rrëzueshme, karakteri i vendimeve gjyqësore në rast të anulimit të kontratave, pasojat juridike të anulimit të kontratave relativisht të pavlefshme, pozita e palëve kontraktuese dhe personit të tretë pas anulimit të kontratës relativisht të pavlefshme si dhe afatet kohore ligjore brenda të cilave mund të kërkohej anulimi i kontratave të rrëzueshme.

Në ditën e dytë është diskutuar për mjetet e sigurimit të ekzekutimit të kontratave, karakteris-

tikat kryesore të këtyre mjeteve, kontraktimi i mjeteve të sigurimit dhe mënyra e realizimit të tyre si dhe procedura gjyqësore për vendosje në konteste të tilla.

Me rastin e këtij trajnimi përmes rasteve praktike janë sqaruar dilema që i referohen kryesisht anulimit të kontratave absolutisht nule dhe atyre relativisht, për mënyrën e te vendosurit të tyre (lloji i vendimit aktvendim apo aktgjykim), pastaj afatshmërisë së tyre, si dhe faktit se në cilat raste gjykata zyrtarisht kujdesët për nulitetin e në cilat raste në bazë të prapësimit të palës.

Po ashtu u sqarua mjaftë mirë se mjetet për sigurimin e kontratave nuk janë detyruese në secilën kontratë, dhe nuk janë pjesë përbërëse e kontratës, por këto mjete palët me marrveshje të ndërsjellta kanë mundësi ti parashohin si mekanizma sigures.

Metodologjia e trajnimit është e karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Këtë trajnim e kanë vijuar 5 gjyqtarë nga DHPGJS, 7 nga Gjykata e Apelit si dhe 61 gjyqtarë nga niveli themelor dhe 1 bashkëpunëtorë profesional.



Trajnim: Provat në procedurën penale. Masat e fshehta të hetimit dhe vëzhgimit si dhe mbrojtja e dëshmitarëve dhetë dëmtuarve (viktimave) si dhe dëshmitarët bashkëpunues

Më 08-09 Mars 2022, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme ka realizuar trajnimin përmes platformës Zoom me temë “Provat në procedurën penale, Masat e fshehta të hetimit dhe vëzhgimit si dhe Mbrojtja e dëshmitarëve dhe të dëmtuarve (viktimave) si dhe dëshmitarët bashkëpunues – Sesioi I”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte të rris kapacitetin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në zbërthimin e provës, relevancën dhe besueshmërinë e provës si parakusht për zgjidhjen e drejtë dhe meritore të rasteve përkatëse.


Në ditën e parë trajnimi është fokusuar në faktet dhe vërtetimi i tyre në procedurën penale, sigurimin e provave në veprimet fillestare të policisë, sigurimi i provave me anë të masve të fshehta të hetimit dhe vëzhgimit si dhe provat në fazën e hetimeve.

Në ditën e dytë është vijuar me aspektin e ligjshmërisë së provave dhe kundërshtimi i tyre, shqyrtimin dhe vlerësimin e provave, besueshmërinë dhe fuqinë provuese.

Pjesëmarrësit patën rastin që përmes rasteve të ndryshme nga praktika gjyqësore të zbërthejnë dispozitat ligjore që rregullojnë sigurimin dhe përdorimin e provave dhe aspekte tjera procedurale me rëndësi në mënyrë që vërttimi i fakteve dhe provave në procedurë penale të bëhet drejtë dhe kryesit e veprave penale të vihen para drejtësisë.

Metodologjia e zbatuar ishte e karakterit të kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Përfitues të këtij trajnimi janë: 60 gjyqtarë, 34 prokurorë, 4 mbrojtës të viktimave si dhe 1 zyrtarë lijor nga prokuroria.



Trajnimi: Bashkëpunimi juridik ndërkombëtarë në çështje penale, mundësitë dhe sfidat

Me 10 Mars 2022, është realizuar trajnimi përmes platformës Zoom me temë “Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjet penale, mundësitë dhe sfidat”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve në fushën e ndihmës juridike ndërkombëtare përkatësisht rreth ekstradimit, transferimit të lëndës, sigurimit të provave dhe kërkesave tjera në çështjet penale për të rritur efikasitetin në ekzekutimin e kërkesave për ndihmë juridike sipas standardeve më të mira ndërkombëtare në bashkëpunimin juridik ndërkombëtarë.

Trajnimi është fokusuar në trajtimin teorik dhe praktik të bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjet penale duke i kushtuar vëmendje të veçantë bazës ligjore të bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në Kosovë, dispozitave ligjore dhe rëndësisë së bashkëpunimit përmes veprimit të shpejtë tek këto raste. Gjatë trajnimit u trajtuan raste të ndryshme të bashkëpunimit me theks te rastet e ekstradimit të personave të kërkuar apo të dënuar, letër rreshtimet ndërkombëtare, transferimet e personave të dënuar dhe transferimi i


procedurës penale, njohja dhe ekzekutimi i aktgjykimeve të huaja, ndihma e ndërsjellët juridike si dhe provueshmëria e provave të siguruara përmes ndihmës juridike ndërkombëtare dhe rrugëve jo formale.

Pjesëmarrësit në trajnim patën mundësinë që gjitha këto çështje të ndihmës së ndërsjellët juridike

t’i elaborojnë përmes skenarëve të ndryshëm dhe në këtë mënyrë zbatuan institute të ndryshme nga fusha e bashkëpunimit juridik ndërkombëtarë duke i identifikuar mundësitë për zbatim dhe arritjes së zgjidhjeve konkrete.

Metodologjia e zbatuar ishte e karakterit të kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 35 gjyqtarë nga Gjykatat Themelore nga të gjitha regjionet, dhe 26 prokurorë, 2 prej tyre nga Prokuroria Speciale dhe 24 të tjerë nga Prokuroritë Themelore nga të gjitha regjionet.



Trajnim: Trafikimi me qenie njerëzore

Me 15-16 Mars 2022, është realizuar trajnimi online përmes platformës Zoom me temë “Trafikimi me qenie njerëzore”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë ligjor për hetimin, akuzimin dhe gjykimin e veprave penale të trafikimit me njerëz në praktikë në mënyrë meritore përmes identifikimit të saktë të elementeve të këtyre veprave dhe zbatimit të drejtë të procedurës dhe legjislacionit në fuqi.

Në ditën e parë trajnimi ka qene i fokusuar në trajtimin e infrastrukturës ligjore për veprën penale të trafikimit me njerëz, elementet e kësaj vepre, dallimi i elementeve të kësaj vepre me elementet e veprave tjera, mekanizmat transnacional të referimit si dhe në hartimin e planit për hetimin dhe identifikimin e viktimave të trafikimit me njerëz dhe indikatorët e hershëm të identifikimit të viktimave të trafikuar.


Në ditën e dytë vëmendje të veçantë i është kushtuar aspekteve procedurale me theks te të

drejtat e viktimave në procedurë, koha e rehabilitimit dhe mbrojtjes së viktimave të trafikuar, ri integritit të viktimave të trafikuar si dhe për procedurën e kompensimit të dëmit për viktimat e trafikuar.

Përveç aspekti material dhe procedural të cilat u trajtuan gjerë e gjatë u vu në pah edhe përhapja me shpejtësi e kësaj vepre në të gjithë botën duke përfshirë edhe Kosovën. Prandaj u inkurajuan profesionistët ligjor që njohuritë e marra gjatë këtij trajnimi ti zbatojnë në praktikë në mënyrë që viktimave t’u sigurohet mbrojtje adekuate dhe kryesit e këtyre veprave të ndëshkohen sipas ligjit.

Metodologjia e zbatuar është e karakterit të kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 5 Gjyqtarë nga Gjykata e Apelit, 30 gjyqtarë nga Gjykatat Themelore, dhe 1 prokuror nga Prokuroria Speciale dhe 19 prokurorë nga Prokuroritë Themelore.



Tryezë për çështje familjare

Akademia e Drejtësisë me 15-16 mars 2022 organizoj tryezën e rumbullakët me titull: “Tryezë për çështje familjare”. Qëllimi i kësaj tryeze ishte trajtimin dhe adresimi i sfidave të praktikës gjyqësore në republikën e Kosovës lidhur me zbatimin e dispozitave materiale dhe procedurale nga fusha e së drejtës familjare e me këtë avancimin e njohurive të gjyqtarëve lidhur me këto sfida.

Në ditën e parë të tryezës u trajtuan çështjet aktuale lidhur me: Aspektet juridiko-familjare të rregulluara nga UE-së dhe legjislacioni i tij; Mënyrat e shuarjes së martesës; Praktika gjyqësore në kontestet statusore; dhe Procedurat e zgjidhjes së martesës (Procedura e shkurorëzimit).

Ndërsa në ditën e dytë u trajtuan çështjet aktuale lidhur me: Rastet tipike nga praktika gjyqësore e GJDBE në Luksemburg në fushën e marrëdhënieve familjare; Detyrimi i Ushqimit - Besimi i fëmijëve; Kundërshtimi dhe vërtetimi i amësisë apo i atësisë; Marrëdhëniet pasurore në mes bashkëshortëve dhe Format e veçanta të mbrojtjes së fëmijëve pa kujdes prindëror (Adoptimi).

Që në fillim u theksua se Republika e Kosovës ka inkorporuar shumicën e instituteve juridike që përmbajnë Konventat, rregulloret dhe urdhëresat e BE-së lidhur me marrëdhëniet juridiko-familjare- statusore dhe trashëgimore. Gjithashtu edhe në Projekt-Kodin e ri Civil (që ka hartuar Qeveria e Kosovës) e që është në procedurë parlamentare janë inkorporuar këto institute dhe zgjidhje që janë në Bashkimin Evropian. Me rëndësi është edhe fakti se vendimet e GJDBE në Luxemburg kanë të bëjnë përveç me shtetet anëtare të BE-se edhe me shtetet e treta, në këtë rast siç është Republika e Kosovës. Gjithashtu edhe me Projektligjin për të Drejtën Ndërkombëtare

Private (që është në procedurë të aprovimit) përmbahen zgjidhjet dhe institutet juridike të lëmis juridike familjare-statusore dhe trashëgimore që përmbajnë konventat, rregulloret dhe urdhëresat e BE-së.

E Drejta e BE-së duhet të zbatohet në mnyrë efikase sepse një e treta e qytetarëve tanë në BE në një mënyrë apo tjetër kanë hyrë apo hyjnë në vazhdimësi në raporte juridiko-familjare statusore dhe trashëgimore nëpër shtete të BE-së ku jetojnë, e drejta e BE-së pastaj zbatohet në këto raporte juridike. Arsye tjetër është orientimi ynë si Kosovë për BE-në, i cili kërkon harmonizimin-përafrimin e secilit ligj me legjislacionin e BE-së duke ditë se kjo e drejtë parasheh barazi, të drejta dhe zgjidhje kualitative në raportet juridiko-familjare.

Në tryezë u potencua edhe mendimi se e drejta familjare si tërësi është rregulluar me Ligjin e Familjes, i cili në vitin 2019, ka pasuar disa ndryshime lidhur me mënyrën e llogaritjes së kontributit të bashkëshortëve, mirëpo në të njëjtën kohë praktika gjyqësore ka njohur zhvillimin e saj në trajtimin e rasteve nga marrëdhëniet martesore dhe familjare e të cilat u trajtuan gjithanshëm. Duke marrë parasysh se çështjet familjare zakonisht janë sfiduese dhe kërkojnë përkushtim dhe profesionalizëm të nivelit të lartë në trajtimin e rasteve sipas kërkesave për mbrojtje gjyqësore, kjo tryezë adresoj problematikat lidhur me zbatimin e drejtë të dispozitave të Ligjit për Familjen të Kosovës.

Ishte një konkludim se tryeza ofroj njohuri të thelluara për gjyqtarët pjesëmarrës lidhur me praktikën e konsoliduar për çështjet që përfshihen në kuadër të fushës së marrëdhënieve martesore dhe familjare.

Me rëndësi ishte edhe trajtimi i çështjeve dhe sfidave të identifikuar në praktikën e gjykatës së shkallë së dytë dhe të tretë e të cilat u prezantuan përmes rasteve konkrete dhe në mënyrë të gjithanshme..

Raste e prezantuara ishin përzgjedhur me kujdes dhe ato mundësuan trajtimin e të gjitha sfidave që kanë të bëjnë në lëmin e çështjeve familjare. Përmes rasteve të përzgjedhura panelistët-moderatorët prezantuan hulumtimet e tyre nga praktika gjyqësore në gjykatat ku punojnë dhe shpjeguan se rastet paraqesin në mënyrë objektive problematikën e çështjeve por edhe mënyrën se si duhet të veprohet në të ardhmen.

Po ashtu prezantimet në tryezë u mbështetën në konceptet ligjore të rregullimit të marrëdhënieve familjare, për çka moderatorët ishin të përgatitur dhe ofruan përgjigjet dhe komentet e tyre të mbështetura në praktikën gjyqësore dhe dispozitat ligjore për të gjitha çështjet e lëmis që u trajtua. Çështjet e trajtuara ishin përzgjedhje e kujdesshme e çështjeve më të rëndësishme dhe aktuale.

Prezantimi i praktikës gjyqësore aktuale e cila ishte pjesë e kësaj tryeze u vlerësua si një burim me dobi jo vetëm për të qartësuar mënyrën e zbatimit të dispozitave ligjore por edhe për të njohur standardet e zhvilluara në këtë fushë.

Tryeza u shoqërua dhe u zhvillua në një ambient interaktiv të diskutimeve dhe pyetjeve

praktike. Prezantimi i temave u bë përmes paraqitjes se disa rasteve praktike të ndërlidhura drejtpërdrejtë me çështjet që u trajtuan sipas agjendës. Moderatorët prezantuan aspektet faktike dhe juridike të rasteve, duke ofruar përgjigje në pyetjet/dilemat mbi të cilat u zhvillua diskutimi. Njëkohësisht ata ofruan përgjigje dhe zgjidhje duke ofruar pikëpamjet teorike/doktrinare, perspektiven ligjore dhe atë të praktikës gjyqësore si mbështetje për përfundimet në tryezë.

Sipas vlerësimit të pjesëmarrësve kjo tryezë dyditore arriti objektivat e saj në kuptim të shpjegimit të çështjeve/dilemave në lëmin e marrëdhënieve juridiko familjare e trashëgimore, rolit dhe ndikimit të praktikës aktuale gjyqësore, kuptimit të jurisprudencës së GJDBE-së në interpretimin dhe vendosjen e standardeve në aplikimin e të drejtave dhe zbatimin e drejtë në praktikë të tyre nga gjykatat dhe organet tjera shtetërore në Kosovë. Në këtë tryezë u përdoren metodat e shpjegimit duke u bazuar në raste nga praktika gjyqësore vendore dhe ajo e GJDBE e duke u shoqëruar me diskutime interaktive, përmes analizës së rasteve studimore, duke zbërthyer dhe sqaruar dispozitat e BE-së si dhe zbatimin e legjislacionit nacional në këtë lëmi.

Përfitues në këtë tryezë ishin gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe të gjykatave themelore në Republikën e Kosovës.



Trajnimi: Zbatimi i të drejtave pronësore dhe intelektuale

Më 17-18 Mars 2022, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Mbështetjen e BE-së për të Drejtat Pronësore Intelektuale në Kosovë, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme kanë realizuar trajnimin me temë “Zbatimi i të Drejtave Pronësore Intelektuale”.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe profesionistëve tjerë ligjor lidhur me bazën ligjore dhe standardet ndërkombëtare të BE-së për mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale për zgjidhjen e drejtë dhe në mënyrë meritore të rasteve në praktikën gjyqësore.

Në ditën e parë janë trajtuar aspekte të rëndësishme nga e drejta e pronësisë intelektuale duke filluar nga Politika dhe praktika e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian e DPI-së (Drejtave të Pronësisë intelektuale) me fokus te interpretimi i nocioneve të asqius së BE-së, Politika dhe praktika e GJDBE-së në fushën e DPI dhe të Drejtat themelore, Praktikrat më të mira për Menaxhimin Kolektiv të të Drejtave të Autorit dhe të Drejtave të Përafërta si dhe Praktikrat më të mira për trajtimin e shkeljes së DPI-së në internet-ambjentin dixhital,

Në ditën e dytë gjyqtarët dhe profesionistët tjerë ligjor pjesëmarrës janë ndarë në dy grupe dhe kanë vijuar trajnimin me përmbajtje adekuate varësisht nga kompetenca dhe

juridiksioni që kanë përfaqësuar.

Në grupin e parë ishin gjyqtarët nga Departamenti i Çështjeve Komerciale dhe Administrative, ndërkaq në grupin e dytë Divizioni për Çështjet Penale të Gjyqtarëve si dhe zyrtarë policor dhe profesionistë tjerë ligjor nga Departamenti i Krimeve Ekonomike.

Në ditën e dytë për grupin e parë trajnimi është fokusuar në masat e përkohshme dhe të drejtat për marrjen e informacionit në rastet e DPI-së, metodat e përcaktimit të demit për shkeljen e të drejtave të autorit dhe të drejtave pronësore industrial, përcaktimi i tarifave të përgjithshme për përdorimin e përmbajtjes me të drejtën e autorit, praktika gjyqësore për shuarjen ose ezaurimin Ndërkombëtar kundrejt Rajonal të DPI-së dhe në fund edhe ushtrime praktike për zbatimin e të drejtës së autorit dhe markave tregtare.

Për grupin e dytë trajnimi u fokusua në natyrën dhe seriozitetin e shkeljeve të DPI-së, kundërvajtjes si formë e shkeljes së DPI-së, qëllimi kriminal lidhur me shkeljen e të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta në dritën e praktikës gjyqësore, sanksionet penale për shkeljen e të drejtave pronësore industrial, standardet ndërkombëtare dhe legjislacioni kombëtarë dhe në fund ushtrime praktike lidhur me hetimin e rasteve të DPI-së dhe dënimi i shkelësit

Pjesëmarrësit në dy grupet patën mundësinë e shqyrtimit të praktikave gjyqësore përkatëse dhe praktikave më të mira të zbatuara në këtë fushë nga perspektiva e ekspertëve të huaj si ish gjyqtarë, avokatë dhe profesionistë tjerë ligjor të përfshirë në Organizata ndërkombëtare të pronësisë intelektuale.

Metodologjia e trajnimit ishte e karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive duke prezantuar dhe raste praktike në zbatimin e të drejtës së autorit dhe markave tregtare.

Këtë trajnim e kanë vijuar 17 gjyqtarë, prej tyre 6 gjyqtarë nga DHPGJS, 1 gjyqtarë i Apelit si dhe 10 të tjerë nga Gjykatat

Themelore. 1 prokurorë si dhe profesionistë tjerë ligjor nga institucione tjera si: 3 zyrtarë policor, 1 zyrtarë ligjor nga Dogana e Kosovës, 2 zyrtarë ligjor nga Ministria e Kulturnës dhe Sporteve si dhe një zyrtarë ligjor nga Ministria e Industrisë dhe Tregtisë.

Tryezë: Liria e shprehjes dhe Liria e Mediave- Regjioni i Gjilanit dhe Ferizajit

Më 17-18 mars 2022, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me JUFREX – Projektin e Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës kanë realizuar tryezën me temë “Liria e Shprehjes dhe Liria e Mediave”.

Tryeza kishte për qëllim të rrisë kapacitetin e profesionisteve ligjore për të zbatuar standardet evropiane dhe ndërkombëtare në fushën e lirisë së shprehjes.

Tryeza në ditën e parë fillimisht është fokusuar në pjesën teorike duke trajtuar veq e veq lirinë e shprehjes, shpifjen dhe mbrojtjen e reputacionit bazuar në legjislacionin vendor dhe me standardet e GJEDNJ-së të cilat më pas janë shoqëruar edhe me rastet gjyqësore të praktikës kosovare. Në vazhdim është diskutuar edhe për paditë strategjike kundër pjesëmarrjes publike si dhe për rolin e Komisionit të Pavarur për Media dhe Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës

në mbrojtjen e reputacionit.

Në ditën e dytë është fokusuar në sigurinë e gazetarëve bazuar në legjislacionin vendor dhe me standardet e GJEDNJ-së të cilat më pas janë shoqëruar edhe me raste nga praktika gjyqësore vendore dhe ajo e GJEDNJ-së.

Pjesëmarrësit përmes rasteve praktike patën mundësinë të njihen me rastet kur ka shkelje të lirisë së shprehjes dhe mediave e në cilat raste jo si dhe të njihen me zhvillimet e fundit në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut për Lirinë e Shprehjes.

Përfitues të kësaj tryeze ishin 7 gjyqtarë të cilit kryesisht ishin të nivelit themelor nga regjioni i Ferizajit dhe Gjilanit, 1 prokuror nga Prokuroria Themelore Ferizaj si dhe 5 avokatë nga regjioni i Gjilanit dhe Ferizajit



Trajnimi - E drejta për jetë private, jetë familjare, të vendbanimit dhe korrespondencës, për tu martuar dhe krijuar familje dhe për barazi të bashkëshortëve – neni 8 Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore

Me 22 Mars 2022, përmes platformës online është realizuar trajnimi me temë: E drejta për jetë private, jetë familjare, të vendbanimit dhe korrespondencës, për tu martuar dhe krijuar familje dhe për barazi të bashkëshortëve – neni 8 KEDNJ-së.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive mbi Konventën Evropiane dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së lidhur me të drejtën për jetën private dhe familjare dhe zbatimin e drejtë të dispozitave të Konventës evropiane dhe kriterëve që ka vënë GJEDNJ lidhur me këtë të drejtë.

Trajnimi fillimisht është fokusuar me pjesën teorike për shkak të specifikave të temave, duke kaluar pastaj në pjesën praktike me raste nga praktika e GJEDNJ-së, por gjithashtu të

ndërlidhura me raste të praktikës kosovare.

Pjesëmarrësit e trajnimit janë njoftuar saktësisht me aspektin e nocioneve dhe përkufizimeve të jetës private, familjare, vendbanimit, korrespondencës si dhe çështjeve tjera që lidhen me nenin 8 të KEDNJ-së. Gjithashtu përmes rasteve praktike ata patën mundësinë të njihen me rastet kur autoriteti shtetëror ndërhyjnë në një të drejtë të tillë, në cilat raste GJEDNJ-ja ka vlerësuar se ndërhyrja e shtetit ka përbërë shkelje të nenit 8 e në cilat raste jo, etj.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 36 gjyqtarë, (4 nga Gjykata e Apelit dhe 32 të tjerë nga Gjykatat Themelore) 6 prokurorë kryesisht nga niveli themelor si dhe 1 bashkëpunëtorë profesional nga Gjykata Themelore në Gjilan.



Program i Specializuar i Trajnimit Pastrimi i parave dhe hetimi financiar– Sesioni I

Më 23-24 Mars 2022, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme ka realizuar trajnimin përmes platformës Zoom me temë “Program i Specializuar i Trajnimit Pastrimi i parave dhe hetimi financiar– Sesioni I”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve në identifikimin e elementeve të veprave penale që ndërlidhen më pastrimin e parave dhe kualifikimin e saktë juridik të këtyre veprave për zgjidhjen e drejtë dhe meritore të rasteve në praktikën gjyqësore.


Gjatë trajnimit në veçanti është diskutuar baza ligjore, vendore dhe ndërkombëtare dhe elementet e veprës penale të pastrimit të parave. Më tej është vazhduar me fazat e pastrimit të parave, kompetencat dhe bashkëpunimi me Njësinë për Inteligjence Financiare. Vëmendje të veçantë i është

kushtuar edhe hetimeve pro aktive penale dhe financiare të cilat sigurojnë prova të pranueshme që mbështesin aktakuzat e ngritura si dhe formave të ndryshme të bashkëpunimit ndërkombëtarë.

Të gjitha këto çështje u elaboruan përmes rastit praktik duke adresuar çështjet më sfiduese gjatë praktikës gjyqësore.

Metodologjia e trajnimit është bazuar në diskutime interaktive të pjesëmarrësve të trajnimit dhe të trajnuesve.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: 8 gjyqtarë, 2 nga Gjykata e Apelit dhe 6 nga Gjykatat Themelore si dhe 11 prokurorë, 7 nga Prokuroritë Themelore, 2 nga Prokuroria Speciale dhe 1 nga Prokuroria e Apelit.



Trajnimi hyrës për Ligjin për politikën e konkurrencës dhe rregullimin e ndihmës shtetërore në Kosovë

Më 25 Mars 2022, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme me Mbështetjen e BE-së për Autoritetin Kosovar të Konkurrencës dhe Komisionin e Ndhmës Shtetërore ka realizuar trajnimin online me temë “Trajnim hyrës për ligjin dhe politikën e konkurrencës dhe rregullimin e ndihmës shtetërore në Kosovë”.

Qëllimi i këtij i trajnimi ishte avancimi i njohurive themelore të gjyqtarëve dhe profesionistëve tjerë ligjor për konceptet themelore të Ligjit dhe politikës së konkurrencës dhe rregullimin e ndihmës shtetërore në Kosovë në përputhje me ligjin dhe praktikën e BE-së.

Trajnimi është fokusuar në trajtimin teorik dhe praktik të Ligjit të BE-së për konkurrencën dhe të Ligjit të BE-së për ndihmë shtetërore dhe zbatimin e tyre në Kosovë. Më pas janë diskutuar veq e veq karakteristikat kryesore të praktikave anti konkurruese dhe mënyra e rregullimit të tyre e gjithashtu edhe karakteristikat kryesore të procesit rregullues të ndihmës shtetërore.

Me rastin e trajnimit u tha që në lidhje me konkurrencën, përfshirë ndihmën shtetërore, Traktati i Komunitetit të Energjisë kërkon që të gjitha palët të ndërmarrin hapa për të luftuar shtrembërimet e tregut dhe pengesat e

konkurrencës në aktivitetet ekonomike në sektorin e energjisë. Ata duhet të sigurojnë që korniza e tyre ligjore të përfshijë dispozita për të adresuar çdo sjellje të njëanshme ose të bashkërenduar anti-konkurruese në aktivitetet ekonomike në sektorin e energjisë. Kjo vlen gjithashtu për të gjitha ndërmarrjet Shtetërore ose organet që u jepen privilegje ekskluzive ose të veçanta nga TKE-ja dhe vendet anëtare të TKE-së.

Gjatë trajnimit u analizuan raste të shumta praktike si nga aspekti i konkurrencës ashtu edhe nga aspekti i ndihmës shtetërore të cilat mundësuan diskutimet e përbashkëta të gjithë pjesëmarrësve dhe njohjen e rasteve kur bien ndesh me konceptet themelore të këtyre ligjeve.

Metodologjia e trajnimit është e karakterit të kombinuar duke përfshirë shpjegime teorike dhe praktike.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 10 gjyqtarë, prej tyre 7 nga Gjykata Themelore dhe 3 nga Gjykata e Apelit si dhe 7 Inspektor hetues në Autoritetin Kosovar të Konkurrencës, Udhëheqës të Divizionit të Pozitës Dominuese në Autoritetin Kosovar të Konkurrencës, 1 zyrtarë ligjor dhe 3 praktikant nga Autoriteti Kosovar i Konkurrencës.



Program i Specializuar i Trajnimit Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare – Sesioni I

Më 29-30 Mars 2022, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme ka realizuar trajnimin përmes platformës Zoom me temë “Program i Specializuar i Trajnimit Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare – Sesioni I”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve në identifikimin e elementeve të veprave penale që ndërliken më veprat penale kundër detyrës zyrtare dhe kualifikimin e saktë juridik të këtyre veprave për zgjidhjen e drejtë dhe meritore të rasteve në praktikën gjyqësore.


Me rastin e këtij trajnimi u potencua që KPRK i kushton një kapitull të tërë veprave penale të korrupsionit zyrtar dhe veprave penale kundër detyrës zyrtare, megjithatë në praktikë shpeshherë paraqiten dilema të ndryshme të cilat ndikojnë në mos efikasitetin për zgjidhjen e rasteve përkatëse.

Prandaj, gjatë trajnimit në veçanti është diskutuar për elementet e veprës penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare duke trajtuar

dashjen si element dhe qëllimin për vërtetimin e veprës penale të korrupsionit. Vëmendje të veçantë i është kushtuar edhe vlerësimit të provave, krijimit të figurës së veprës penale të korrupsionit me prova rrethore. Më tej është vazhduar edhe me mashtrimin në prokurim, keqpërdorimin e pozitës dhe autoritetit zyrtar, konfliktin e interesit dhe çështje tjera të rëndësishme që hyjnë në këtë kuadër të veprave. Të gjitha këto çështje u elaboruan përmes analizimit të rasteve praktike dhe duke zbërthyer dispozitat ligjore që i referohen këtyre veprave.

Metodologjia e trajnimit është bazuar në diskutime interaktive të pjesëmarrësve të trajnimit dhe të trajnuesve.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: 33 pjesëmarrës. Prej tyre ishin 29 gjyqtarë, 26 nga Gjykatat Themelore dhe 3 nga Gjykata e Apelit si dhe 4 prokurorë nga Prokuroria Themelore.



Trajnim: Mbrojtja e gjyqtarëve dhe prokurorëve të përfshirë në rastet kundër korrupsionit

Më 29-30 Mars 2022, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme në bashkëpunim me EULEX ka realizuar trajnimin me temë: “Mbrojtja e gjyqtarëve dhe prokurorëve të përfshirë në rastet kundër korrupsionit”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte njohja e gjyqtarëve dhe prokurorëve që punojnë në zgjidhjen e rasteve kundër korrupsionit për mënyrat e mbrojtjes së tyre nga format e ndryshme të pengimit dhe kërcënimet e mundshme ndaj tyre.

Me rastin e këtij trajnimi u diskutua për legjislacionin dhe parimet kombëtare dhe ndërkombëtare në deontologjinë gjyqësore dhe të drejtësisë, për llojet e ndryshme të

kërcënimeve, analizën e çdo lloji të kërcënimeve të identifikuara si dhe për sfidat në mbrojtjen e gjyqtarëve përmes sistemeve të ndryshme. Vëmendje e veçantë i është kushtuar krijimit të dy organeve në kuadër të KPK-së dhe KGJK-së si mekanizma mbështetës për gjyqtarët dhe prokurorët.

Metodologjia e trajnimit ishte e karakterit të kombinuar duke përfshirë shpjegime teorike dhe praktike dhe shembuj të praktikës gjyqësore.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 9 gjyqtarë, prej tyre 7 nga Gjykata Themelore, 1 nga Apeli dhe një nga Gjykata Supreme – Departamenti Special dhe 4 prokuror nga Prokuroria Speciale e Republikës Kosovës.



Aktivitetet për stafin administrative gjyqësor dhe prokurorial

Trajnimi: Menaxhimi i dosjes dhe lëndës në sistemin gjyqësor

Me 16 mars 2022, në kuadër të Programit për Trajnime të vazhdueshme për stafin administrativ të gjykatave është realizuar trajnimi online me temë: “Menaxhimi i dosjes dhe lëndës në sistemin gjyqësor”.


Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi dhe aftësimi i stafit administrativ të gjykatave në formën e menaxhimit të dosjeve dhe lëndëve gjatë punës së tyre të përditshme.

Trajnimi u fokusua në parimet e menaxhimit të rrjedhës së rasteve, format e menaxhimit të cilat mundësojnë efikasitetin e gjykatës. Gjithashtu vëmendje e veçantë i ’u kushtua edhe kontrollimit të shtyrjeve të rasteve që ndikon në efikasitetin dhe efektivitetin jo vetëm të gjyqtarit individual por edhe gjykatës


në përgjithësi si dhe besimit të publikut.

Më tej trajnimi u fokusua edhe në kontributin e stafit administrativ në menaxhimin e dosjeve duke ofruar zgjidhjen përmes kontrollimit kohë pas kohe të lëndëve, afateve dhe veprimeve tjera procedurale që janë ndërmarrë me qëllim që të zbatojnë në praktikë këto teknika të cilat janë dëshmuar për menaxhim të suksesshëm të rasteve në vendet e punës.

Përfitues të trajnimit ishin gjithsejtë 14 pjesëmarrës të cilët vinin nga radhët e administratorëve, ndihmës administratorëve, shefat e ZML-së, referentët dhe zyrtarët, nga Gjykatat Themelore brenda Republikës së Kosovës.



Trajnimi: Regjistrat, raportet statistikore dhe dashboardet e SMIL



Më 24 mars 2022, në bashkëpunim me Këshillin Gjyqësor të Kosovës, e financuar dhe mbështetur edhe nga Këshilli i Evropës, projekti - Forcimi i cilësisë dhe efikasitetit të drejtësisë në Kosovë KoSEJ II, është realizuar trajnimi me temë: “Regjistrat, raportet statistikore dhe dashboardet e SMIL”, për stafin administrativ të gjykatave.

Qëllimi i trajnimit ishte që stafi administrativ i gjykatave, në veçanti administratorët, zyrtarët e statistikave, zyrtarët e IT, të informohen më shumë rreth prezantimit të regjistrave në të

gjitha nivelet e gjykatave.

Trajnimi u fokusua në prezantimin e regjistrave të gjykatave, përkatësisht llojeve të regjistrave në SMIL, civile dhe penale si dhe të dashboardeve për të gjitha nivelet e gjykatave veq e veq.

Pjesëmarrësit gjatë trajnimit patën mundësinë e diskutimit dhe evitimit të paqartësive ose pengesave eventuale që paraqiten në praktikë përmes metodave dhe teknikave të prezantuara nga trajnuesit, përkatësisht shefi i zyrës së TIK-ut dhe analistja e lartë për sisteme në SKGJK..

Përfitues të trajnimit ishin gjithësej 35 pjesëmarrës të cilët vinin nga radhët e Administratorëve Ndihmës administratorëve, Shefave të ZML-ve, referentëve zyrtarëve të statistikave dhe zyrtarëve të IT-së brenda gjykatave.



Trajnimi: Pjesa e përgjithshme dhe e Posaçme e së Drejtës Penale -Grupi I

Më 29-31 Mars 2022, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me UNDP, ka realizuar 3 trajnime për Grupin e I-rë nga Moduli Bazik për bashkëpunëtor profesional dhe zyrtar ligjor me temë “Pjesa e përgjithshme dhe e posaçme e së drejtës penale”.

Për të mundësuar pjesëmarrjen në trajnime të gjithë bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor të gjykatave dhe prokurorive që punojnë në fushën penale, Akademia e Drejtësisë i ka ndarë në 4 grupe.

Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte avancimi i njohurive të bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor të gjykatave dhe prokurorive lidhur me kornizën ligjore në fushën penale dhe zbatimin e drejtë në praktikën gjyqësore për zgjidhjen meritore të rasteve.

Në kuadër të këtyre sesioneve trajnuese nga pjesa e përgjithshme e së drejtës penale u diskutua për parimet e përgjithshme në zbatimin e Ligjit më të favorshëm me fokus te vlerësimet lidhur me zbatimin e ligjit më të favorshëm, pastaj për veprat penale, elementet, mënyra e kryerjes, koha dhe vendi i kryerjes së veprës penale. Në vazhdim është diskutuar edhe për shkaqet e përjashtimit të kundërligjshmërisë me theks te mbrojtja e nevojshme, nevoja ekstreme, dhuna dhe kanosja, vepra e rëndësishme së vogël dhe përgjegjësia penale.

Në kuadër të pjesës së posaçme është diskutuar për veprat penale kundër jetës dhe trupit me theks te vrasja dhe vrasja e rëndë si dhe për veprat penale kundër integritetit seksual duke trajtuar me vëmendje të veçantë aspekte të rëndësishme të dhunimit dhe sulmit seksual.

Gjatë trajnimit, pjesëmarrësit patën rastin që përmes rasteve të shumta studimore të bashkëpunimit në kryerjen e veprave penale dhe ndihmës në kryerjen e veprave penale të diskutojnë dhe të japin opinione ligjore dhe njëkohësisht të zbërthejnë dispozitat ligjore.

Përfitues në trajnimin e parë ishin 44 pjesëmarrës, prej tyre 21 bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor nga gjykatat, 22 bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor nga prokuroritë si dhe 1 bashkëpunëtorë profesional nga ANJF.

Përfitues në trajnimin e dytë ishin 41 bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor të gjykatave dhe prokurorive. Prej tyre 20 nga gjykatat dhe 20 nga prokuroritë si dhe një bashkëpunëtorë. profesional nga ANJF.

Përfitues në trajnimin e tretë ishin 42 bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor të gjykatave dhe prokurorive. Prej tyre 21 nga gjykatat dhe 20 nga prokuroritë si dhe një bashkëpunëtorë profesional nga ANJF.



Aktivitetet për profesionistët tjerë ligjor

Trajnimi: Ligji për të drejtën sendore dhe praktika gjyqësore në të drejtën pronësore

Më 17 mars 2022, në sajë të bashkëpunimit me GIZ është realizuar trajnimi me temë: “Ligji për të drejtën sendore dhe praktika gjyqësore në të drejtën pronësore”.

Trajnimi i është dedikuar zyrtarëve të ndihmës juridike falas me qëllim të ngritjes së kapaciteteve profesionale dhe përmirësimit të shërbimeve të tyre për qytetarët të cilët kanë nevojë për ndihmë juridike në fushën pronësore.

Trajnimi është fokusuar në trajtimin e aspektit material dhe procedural të legjislacionit të aplikueshëm në Kosovë në fushën pronësore juridike, Ligjit për marrëdhëniet themelore pronësore –juridike të vitit 1980 si dhe Ligjit për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore i vitit 2009. Vëmendje të veçantë kishte fitimi dhe mënyrat e fitimit të pronësisë sipas LTHMP dhe mbrojtja dhe pushimi i drejtës së pronësisë duke

adresuar edhe pyetjet dhe dilemat që kishin zyrtarët e ndihmës juridike falas gjatë procedimit të këtyre çështjeve në gjykatë.


Me rastin e këtij trajnimi pjesëmarrësit patën mundësinë e analizimit të rasteve studimore nga praktika gjyqësore dhe përfitimit të rekomandimeve nga trajnuesit për zgjidhjen e drejtë dhe meritore të rasteve përkatëse.

Metodologjia e këtij trajnimi është zhvilluar në mënyrë të kombinuar me anë të metodës interaktive dhe me raste praktike.




Përfitues në këtë trajnim ishin 16 zyrtarët e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas nga gjitha regionet.






Vijueshmëria në trajnime në PTF e shfaqur përmes grafikoneve



Vijueshmëria në trajnime në PTV e shfaqur përmes grafikoneve



Vijueshmëria në trajnime në PTV përmes grafikoneve



Akademia e Drejtësisë

<https://ad.rks-gov.net>

infoad@rks-gov.net

Rr. "Muharrem Fejza"-Prishtinë

Tel:+383 38 200 18 660